

## KONTRATE SHITJE



Sot ne Tirane me date 11.04.2003, ndermjet paleve;

- SHITES:** Shoqeria "EDITA"S.r.l, person juridik Italian me nr. CCIAA 476964, me seli ne, V.le Spartaco Lavagnini 42 -50129 Firenze e perfaqesuar nga Dario Berti, shtetas Italian lindur me 10.11.59, me banim ne Firenze, pasaporte nr. 208196P.
- BLERES:** Ylli Sula, shtetas shqiptar, lindur me 01.08.1966, banues ne Tirane Rruga Mihal Grameno nr 210/1, me pasaporte nr. 0067992.

### MEQENESE

Shitesi Shoqeria "EDITA"S.r.l, zoteron 35 pjese qe perbejne 35% te kapitalit te Shoqerise shqiptare "ÇELESI"Sh.p.k e rregjistruar me vendimin e Gjykates se Tiranes nr. 18233, date 04.12.1997.

Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, date 11.04.2003, Asambleja ka dhene miratimin per shitjen e 5 pjeseve qe perbejne 5% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, nga pronari Shoqeria "EDITA"S.r.l, te Ortakut Ylli Sula, perkundrejt çmimit prej 5.000Leke.

### PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE VIJON

1. Shitesi Shoqeria "EDITA"S.r.l, i shet Bleresit Ylli Sula 5 pjese qe perbejne 5% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, perkundrejt çmimit 5.000Leke.
- 1.1 Bleresi Ylli Sula I pagoi Shitesit Shoqerise "EDITA"S.r.l, te gjithë vleren e çmimit te shitjes prej 5.000Leke, per vertetimin e shlyerjes se pageses, vlen kjo kontrate e nenshkruar nga te dyja palet.
2. Ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate Bleresi fiton pronesine mbi 5 pjeset qe perbejne 5% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, duke rritur pjesemarrjen ne kapitalin e kesaj shoqerie, ndersa Shitesi humb ne menyre te plote dhe definitive pronesine mbi to dhe mbi çdo te drejte tjeter qe I rridhte prej tyre.
3. Shitesi dhe Bleresi autorizojne qe kjo kontrate te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo kontrate kontrate hartohet ne 5 kopje me vlere te njejte, nga te cilat tre ne gjuhen shqipe dhe dy ne gjuhen Italiane dhe nenshkruhet nga Shitesi dhe Bleresi.

### P A L E T

SHITES  
Shoqeria "EDITA"S.r.l

Dario Berti

BLERES  
Ylli Sula

Ylli Sula